



Action for
Democratic Society

Action for Democratic Society (ADS)

Projekti "Hibrid.info"



Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Fakulteti i Filologjisë

Departamenti i Gazetarisë

Memorandum Bashkëpunimi/Mirëkuptimi

Në mes të

Action for Democratic Society (ADS), projekti "Hibrid.info"

dhe

Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Fakultetit Filologjisë

Departamenti i Gazetarisë

05/ maj/2022

Memorandumi Bashkëpunim

Ky Memorandum Bashkëpunimi (MB) është bërë nga dhe ndërmjet:

- (1) Platformës për kontroll të fakteve hibrid.info nga ADS dhe
- (2) Departamentit të Gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë, pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për bashkëpunim në fushën e informimit, hulumtimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të materialeve dhe përvojave në fushën profesionale mes dy palëve.

Synimet:

- (a) Në përputhje me interesat dhe objektivat e tyre përkatëse, Hibrid.info dhe Departamenti i Gazetarisë janë të gatshëm të bashkëpunojnë për të avancuar nivelin profesional në fushën e mediave, si dhe azhurnimin me praktikat moderne në këtë fushë.
- (b) Qëllimi i këtij MB është të përshkruajë fushat e bashkëpunimit në promovimin e informimit korrekt, objektiv, të paanshëm dhe profesional për audiencën në Kosovë dhe atë shqiptare në përgjithësi.

PRANDAJ:

Preambula dhe deklaratat e mësipërme do të formojnë një pjesë integrale të këtij memorandumi.

1. Qëllimi dhe Objektivat

Hibrid.info dhe Departamenti i Gazetarisë ndajnë një qëllim të përbashkët, përkatësisht edukimin mbi median dhe informimin korrekt, objektiv, të paanshëm e profesional për audiencën në Kosovë dhe atë shqiptare në përgjithësi. Gjithashtu, pjesë përbërëse e qëllimit të këtij bashkëpunimi është ngritja e nivelit cilësor të aktiviteteve trajnuese të gazetarëve dhe aktivistëve lidhur me informimin e publikut për rolin dhe rëndësinë e verifikimit të fakteve dhe luftimit të dezinformimit në Kosovë. Ndërsa ky qëllim arrihet përmes objektivave specifike:

- (A) Palët nënshkruese të këtij MB të angazhohen për bashkëpunim në të gjitha aktivitetet;
- (B) Palët nënshkruese të këtij MB të angazhohen në promovimin e aktiviteteve të përbashkëta.

2. Rolet dhe bashkëpunimi

Hibrid.info dhe Departamenti i Gazetarisë kanë diskutuar dhe kanë rënë dakord për bashkëpunim në aktivitete specifike të renditura si më poshtë:

1. Studentët dhe stafi akademik i Departamentit të Gazetarisë, do të mund të përfshihen në projekte të hibrid.info, pas pasur nevojë të përcillen proceset formale;
2. Shkëmbimi i informatave dhe materialeve edukuese, për nevoja të iniciativave nga të dyja palët;
3. Shkëmbim profesional në mes të stafit të hibrid.info dhe stafit akademik të Departamentit të Gazetarisë;
4. Bashkëpunime për fushata edukuese e vetëdijësuese;
5. Bashkëpunime për trajnime dhe punëtori;
6. Organizime të përbashkëta të seminareve, punëtorive e konferencave me interes të përbashkët;
7. Organizime të përbashkëta të edukimit të vazhdueshëm afatshkurtër për tema me interes të përbashkët dhe pjesëmarrje të dy palëve në aktivitete;
8. Të përgatisin së bashku Projekt-Propozime dhe të angazhohen në programe kërkimore, trajnime apo projekte tjera të sponsorizuara nga agjencitë financuese (donatorët) dhe pjesëmarrje të dy palëve në aktivitete;
9. Bashkëpunim në ndërtimin e softuerëve të automatizuar për nevoja të informimit dhe fusha tjera;
10. Mundësi për praktikë të studentëve në platformën për kontroll të fakteve – hibrid.info;
11. Promovim reciprok i materialeve specifike që të dyja palët i konsiderojnë se janë të rëndësishme së veçantë, për të rritur impaktin dhe për të pasur efekt më të gjerë tek audienca;
12. Bashkëpunim në projekte dhe aktivitete që kontribuojnë në arritjen e qëllimit të MB-së
13. Aktivitete tjera që mund të identifikohen në vazhdim të bashkëpunimit, mund të paraqiten si aneks apo shtojcë e MB-së.

3. Afati

Mandati i kësaj MB-je do të zgjasë për pesë (5) vjet, përveç nëse përfundohet më herët siç parashihet edhe përmes këtij dokumenti. Ky MB mund të përfundojë nga secila palë, me ose pa shkak, tridhjetë (30) ditë pas njoftimit me shkrim të palës tjetër.

4. Fshehtësia - Konfidencialiteti

Palët obligohen që të ruajnë konfidencialitetin e informatave që dalin si rezultat i bashkëpunimit tek palët e treta, përveç në rastet kur ato janë publike.

Në rast se ndodhë shkelja e konfidencialitetit, obligohet prishja e këtij memorandumi.

5. Të tjera

Asnjë marrëdhënie ligjore detyruese nuk do të hyjë në fuqi midis palëve. Çështjet e përmendura në MB bazohen vetëm për arritjen e qëllimit të paraqitur dhe aktiviteteve që janë në të mirë të dyja palëve dhe komunitetit në përgjithësi, duke mos krijuar përgjegjësi ligjore nga asnjëra palë. Përmbajtja e këtij dokumenti lejon vetëm bashkëpunim të ndërsjellë, por jo edhe të drejtë për të interpretuar si pronësi në aktivitete, ortakëri apo ndërmarrje të përbashkët.

Si dëshmi e kësaj, palët kanë marr përsipër që ta nënshkruajnë këtë MB me emrat e përfaqësuesve, duke bërë që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit:

Pala inicuese

Pala përcjellëse

Shkelzen Osmani

Themelues dhe Drejtor

ADS/hibrid.info



Prof. Dr. Lindita Sejdiu-Rugova

Dekane e Fakultetit të Filologjisë



Prof.ass.dr. Muhamet Jahiri

Shef i Departamentit Gazetarisë



Data: 05.05.2022

Data: 05.05.2022